



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE

RELACION

PËR

“DHËNIEN E PËLQIMIT PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË TË PRONAVE, IDENTIFIKUAR SI PASURITË ME NR. 2/12 VOL. 27, FAQE 167; Nr, 2/539-ND, VOL. 27, FAQE 168; TRUALLI NËN NDËRTESEN NR. 2/708-N1, PJESË E PASURISË NR. 2/10, VOL. 33, FAQE 19, SIPAS HARTES BASHKANGJITUR”

Bazuar në VKM nr. 1532 datë datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Korçë të Qarkut të Korçës” Bashkisë Korçë i janë transferuar një listë pronash të paluajtshme në pronësi ose në përdorim.

Bazuar në VKM-në e sipërcituar, këto pasuri, të inventarizuara në zërat 665 të listës së inventarit, janë transferuar në pronësi të Bashkisë Korçë. Si rrjedhojë Bashkia Korçë gëzon tagrat e plotë të pronarit mbi këto lloj pasurish.

Këto pasuri aktualisht i janë dhënë me huapërdorje Këshillit të Qarkut Korçë me qëllim që ky i fundit të ushtrijë funksionet dhe kompetencat e tij në këto ambiente.

Me shkresën nr. 48 prot dt 19.01.2024, protokolluar në tonën me nr. 559 prot dt. 22.01.2024 nga Këshilli i Qarkut Korçë është kërkuar që pasuritë e individualizuara kati i parë i pasurisë nr. 2/12 vol 27, faqe 167, kati i parë i pasurisë nr. 2/539-nd, vol. 27, faqe 168 dhe pasuria truall (pjesa nën ndërtesën nr. 2/708-N1 me sip 652.88 m2 në pronësi të Këshillit të Qarkut) me nr. 2/10, vol 33 faqe 19, ti kalojnë në pronësi këtij të fundit, për të mundësuar disa ndërhyrje të nevojshme në rrjetin elektrik të godinës, në sistemin e ngrohjes por dhe në ambientet e tjera ku ka nevojë për mirëmbajtje.

Në kuadër të ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të Këshillit të Qarkut Korçë dhe me qëllim realizimin e investimeve mbi këto pasuri, nevojitet kalimi në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë të *pasurive identifikuar sipas hartës bashkëngjitur* këtij relacioni.

Për këtë qëllim kërkohet nga Këshilli i Bashkisë Korçë dhënien e pëlqimit për fillimin e procedurave të transferimit të pronave të sipërcituara nga pronari Bashkia Korçë, në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë.

Qëllimi i transferimit është për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të Këshillit të Qarkut dhe investimi në infrastrukturën e godinës, për ndërhyrjet e nevojshme në rrjetin e energjisë elektrike, në sistemin e ngrohjes së godinës dhe mirëmbajtja e saj.

Pas verifikimeve të kryera në terren nga ana e specialistëve të Bashkisë Korçë, sipërfaqja e përgjithshme për transferim në favor të Këshillit të Qarkut Korçë është 1444.48 m²; nga e cila 791.6 m² ndërtesë dhe 652.88 m² truall.


Bazuar në sa u tha më sipër, i kërkohet Këshillit të Bashkisë Korçë të japë pëlqimin për fillimin e procedurave, për transferimin e sipërfaqes prej 791.6 m² ndërtesë dhe 652.88 m² tokë truall nën ndërtesë, me vendodhje në Lagjen 7, Rruga "28 Nëntori", identifikuar si pasuritë me nr. 2/12 vol 27, faqe 167 me sipërfaqe 349.6 m² (kati i parë i godinës), pasuria nr. 2/539-nd, vol. 27, faqe 168 me sipërfaqe 442 m² (kati i parë i godinës) dhe pjesa truall nën ndërtesën nr. pasurie 2/708-N1, identifikuar me nr. 2/10, vol 33 faqe 19, me sipërfaqe 652.88 m² sipas hartës bashkangjitur ketij relacioni.

Si rrjedhojë, bazuar në nenin 9 pika 1.2 gërmat a) "njësitë e qeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e tyre të paluajtshme sipas mënyrës së përcaktuar në ligj" dhe c) "e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës" të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjin 8744 datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore, njësite të qeverisjes vendore" dhe VKM nr. 1532 datë datë 19.11.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Korçë të Qarkut të Korçës" e ndryshuar i propozojmë Këshillit Bashkiak Korçë të japë pëlqimin për fillimin e procedurave për transferimin e pronave me nr. 2/12 vol 27, faqe 167 me sipërfaqe 349.6 m² (kati i parë i godinës); pasuria nr. 2/539-ND, vol. 27, faqe 168 me sipërfaqe 442 m² (kati i parë i godinës) dhe pjesa truall nën ndërtesën nr. pasurie 2/708-N1, identifikuar me nr. 2/10, vol 33 faqe 19, me sipërfaqe 652.88 m² sipas hartës bashkangjitur ketij relacioni, nga pronari Bashkia Korçë, në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë.

Bashkangjitur ketij relacioni planvendosje e pasurive.

Drejtori e Përgjithshme:

A. Qeramixhi (Dishnica)




Drejtoresha e DPKZHT

Zhaneta Lubonja



KRYETAR I BASHKISË

Sotiraq Filo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr. _____, datë _____.02.2024

PËR

“DHËNIEN E PËLQIMIT PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË TË PRONAVE, IDENTIFIKUAR SI PASURITË ME NR. 2/12 VOL. 27, FAQE 167; Nr, 2/539-ND, VOL. 27, FAQE 168; TRUALLI NËN NDËRTESËN NR. 2/708-N1, PJESË E PASURISË NR. 2/10, VOL. 33, FAQE 19, SIPAS HARTES BASHKANGJITUR”

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike bazuar në nenin 9 pika 1.2 gërma a) të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore, njësive të vetëqeverisjes vendore”, dhe VKM nr. 1532 datë datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Korçë të Qarkut të Korçës” e ndryshuar në Ligjin 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të japë pëlqimi për fillimin e procedurave për transferimin e sipërfaqes prej 791.6 m2 ndërtesë dhe 652.88 m2 truall, me vendodhje në Lagjen 7, Rruga “28 Nëntori”, identifikuar si pasuritë me nr. 2/12 vol 27, faqe 167 me sipërfaqe 349.6 m2 (kati i parë i godinës); pasuria nr. 2/539-ND, vol. 27, faqe 168, me sipërfaqe 442 m2 (kati i parë i godinës) dhe pjesa truall nën ndërtesën nr. pasurie 2/708-N1, identifikuar me nr. 2/10, vol 33 faqe 19, me sipërfaqe 652.88 m2, sipas hartës bashkangjitur këtij relacioni, nga pronari Bashkia Korçë, në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë, me qëllim ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të këtij të fundit, investimin në infrastrukturën e godinës, për ndërhyrjet e nevojshme në rrjetin e energjisë elektrike, në sistemin e ngrohjes së godinës dhe mirëmbajtja e saj.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerzore dhe Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimi të Territorit, Bashkia Korçë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

ANA VERUSHI

Miratuar me _____ vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____

GEN - PLAN

SH. 1:500



Zk. 8564, Pas. nr. 2/10, TRUJALL Siperfaqe = 1561.6 m² (inventari i pronave)

Siperfaqe per kalim pronesie = 652.88 m² (trualli nën pasurinë 2/708-nd)

— Objekti

PUNOI: A. GREMI

Arber

Gremi

Digitally signed by
Arber Gremi
Date: 2024.07.19
14:51:47 +0200